



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 3258 Prot

Gjirokastër më, 07 / 04 / 2026

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së datës 30.03.2026

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës. 30.03.2026.

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot më 30.03.2026 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet pranë UNED-it. Mbledhja fillon në orën 12:06.

Marrin pjesë në mbledhje 17 anëtarë prezent dhe 1 online ( Etleva Kondi). Mungojnë në mbledhje këshilltarët Rova , Peta, Pandos, Kristidhi, Feruni, Shehaj, Aliko ,Novi , Drasa, Kore, Leskaj, Hilaj, Qeli .

Hapet mbledhja nga Znj. Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj hap mbledhjen dhe lexon rendin e ditës duke njoftuar këshilltarët se ka dhe disa pika që nuk janë shënuar te rendi i ditës që kanë të bëjnë me :

P/ Vendim " Për vendosjen e z. Jupe Asllanaj në Shtëpinë e të Moshuarve " Shpresa e Jetës", Gjirokastër"

P/ Vendim " Për vendosjen e znj. Nimete Bilica në Shtëpinë e të Moshuarve " Shpresa e Jetës", Gjirokastër"

P/ Vendim " Për miratimin e akt-marreveshjes dy palëshe me Këshillin e Qarkut"

P/Vendim " Për shpërndarjen e grantit të performancës"

Znj. Isaraj hedh në votim miratimin e kërkesës së Bashkisë Gjirokastër për shtimin e pikave së sipër cituar në rendin e ditës,

Miratohet me 16 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online futja e pikës së mësipërme në rendin e ditës.

Miratohet rendi i ditës me 17 vota pro.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.02.2026 ora 12:00.
2. P/Vendim " Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar të bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% për muajin mars 2026.
3. P/Vendim "Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet dhe individët për muajin mars 2026".
4. P/Vendim" Për tavanet përgatitore buxhetore në nivel programi për PBA 2027-2029 në Bashkinë Gjirokastër".

5. P/Vendim " Për një ndryshim të pikës 2 të VKB-së Nr. 92, datë 22.12.2025 " Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2026"
6. P/ Vendim " Për miratimin e akt-marrëveshjes dy palëshe me Këshillin e Qarkut"
7. P/Vendim " Për shpërndarjen e grantit të performancës"
8. P/ Vendim " Për vendosjen e z.Jupe Asllanaj në Shtëpinë e të Moshuarve " Shpresa e Jetës", Gjirokastër"
9. P/ Vendim " Për vendosjen e znj. Nimete Bilica në Shtëpinë e të Moshuarve " Shpresa e Jetës", Gjirokastër"

10. Trajtim i kërkesave të qytetarëve.

- Hidhet në votë dhe miratohen me 16 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 17 vota pro procesverbali i mbledhjes së datës 27.02.2026.
- Znj. Isaraj lexon pikën 2 dhe 3 të rendit të ditës të cilat kanë kaluar dhe janë miratuar sot në mbledhjen e Komisionit të Shëndetësisë, Mirëqenies Sociale , Rinisë dhe Barazisë Gjinore.  
P/Vendim " Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar të bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% për muajin mars 2026.  
P/Vendim "Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet dhe individët për muajin mars 2026".  
Hidhet në votë dhe miratohen me 17 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 18 vota pro.
- Znj. Isaraj, kalohet në votim pika 4 e cila është:  
P/Vendim" Për tavanet përgatitore buxhetore në nivel programi për PBA 2027-2029 në Bashkinë Gjirokastër".  
Z. Petrit Brahimi pyet përfaqësuesit e bashkisë që të japin sqarime te hollësishme.  
Z. Llogo përgjigjet se ne si komision kemi kaluar dhe verifikuar materialin e propozuar nga aparati. Është një procedurë rutinë që bëhet cdo vit. Nëse dikush nga të pranishmit ka pyetje me materialin kemi këtu Drejtoreshën e Financës që mund të japi sqarime.  
Znj. Isaraj hedh në votim pikën 4 të rendit të ditës dhe miratohen me 16 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 17 vota pro dhe një abstenim ( Anila Cacaj)
- Znj. Isaraj, kalohet në votim pika 5 e cila është:  
P/Vendim " Për një ndryshim të pikës 2 të VKB-së Nr. 92, datë 22.12.2025 " Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2026"  
Z. Aranit Muho pyet se sa është ky ndryshim dhe sa ndikon në buxhetin e bashkisë në këto raste drejtoresha e financë duhet të japi sqarime.

Znj. Florida Celo i përgjigjet se ndryshimi i nivelit të pagave po kalohet në parim sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 103, datë 11.02.2026 të Këshillit të Ministrave. Sipas kësaj VKM-je nuk ka ndryshime në strukturë apo në nr e punonjësve por vetëm nivelin e pagave duke u indeksuar pagat e punonjësve ekzistues në të gjitha nivelet.

Znj. Isaraj hedh në votim pikën 5 të rendit të ditës duke u miratuar me 17 vota pro dhe një votë kundër ( Enkelejda Mahmutaj)

- Znj. Isaraj, kalohet në votim pika 6 e rendit të ditës e cila është:  
P/ Vendim “ Për miratimin e akt-marrëveshjes dy palëshe me Këshillin e Qarkut” e kemi dhe kaluar dhe herë tjetër , është thjesht procedurë, cështje dokumentacioni. Ka dicka nga ana e këshilltarëve?

Znj. Isaraj hedh në votim pikën 6 të rendit të ditës duke u miratuar me 18 vota .

- Znj. Isaraj, kalohet në votim pika 7 e rendit të ditës e cila është:  
P/Vendim “ Për shpërndarjen e grantit të performancës”  
Z. Petrit Brahim i pyet aparatën se për çfarë bëhet fjale të na sqarohet ky material.  
Znj. Florida Celo i përgjigjet se: Në zbatim të kriterëve dhe procedurave për treguesit e për shpërndarjen e fondit të grantit bazuar në performancën e bashkive për vitin 2025, Bashkia Gjirokastrë ka përfituar grantin nga kapitulli 01 në vlerën e 449,438.2 lekë dhe grantin me burim financimi nga financimi i huaj kapitull 02, në vlerën 555,546.59 lekë . këto lekë do të shpërndahen për planin strategjik për vitin 2026.  
Znj. Isaraj hedh në votim pikën 7 të rendit të ditës duke u miratuar me 18 vota .

- Znj. Isaraj, kalohet në votim pika 8 dhe 9 e rendit të ditës ,e cila është:

P/ Vendim “ Për vendosjen e z.Jupe Asllanaj në Shtëpinë e të Moshuarve “ Shpresa e Jetës”, Gjirokastrë”

P/ Vendim “ Për vendosjen e znj. Nimete Bilica në Shtëpinë e të Moshuarve “ Shpresa e Jetës”, Gjirokastrë”

Znj. Isaraj pyet këshilltarët nëse kanë dicka në lidhje me këto pika.

Znj. Isaraj hedh në votim pikën 8 dhe 9 të rendit të ditës duke u miratuar me 17 vota pro pasi z. Gentian Llogo është larguar më herët nga mbledhja.

Gjithashtu znj. Isaraj pyet këshilltarët për materialin që i është vendosur në dispozicion për njohje nga aparatën “ Raporti i Monitorimit të zbatimit të buxhetit Janar-Dhjetor 2025” nëse i është vendosur në dispozicion dhe janë njohur me të.

Këshilltarët konfirmojnë se janë njohur me materialin e vendosur në dispozicion nga bashkia.

Znj. Isaraj , nëse nuk gjë tjetër për të shtuar ju falenderoj dhe e mbyllim këtu këtë mbledhje.

**SEKRETAR I KËSHILLIT**  
**Bexhet BAXHELLA**



**KRTETARI I KËSHILLIT**  
**Merita ISARAJ**

